**UDHËZIM**
**Nr. 1, datë 10.1.2023**

# PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 36, DATË 25.9.2015, "PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe nenit 29, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 36, datë 25.9.2015, "Për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar", bëhet shtesa si më poshtë:

a) Pas pikës 2 shtohet:

"2/1. Një prej kandidatëve për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, që përfaqëson shtresa të margjinalizuara, dhe konkurron pas thirrjes publike, përzgjidhet pavarësisht kritereve të përcaktuara në pikën 2, të këtij udhëzimi".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe komisioni i përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
**Evis Kushi**